



**Statuti i Bordit Editorial të periodikut shkencor
“Buletini i Shkencave Gjeologjike”**

Neni 1

Statuti, botuesi dhe bashkëautor i periodikut shkencor “Buletini i Shkencave Gjeologjike”

1. “Buletini i Shkencave Gjeologjike” është periodik shkencor i njojur nga institucioni përgjegjës për certifikimin e periodikëve shkencorë të Republikës së Shqipërisë.
2. Ai botohet nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, të paktën një herë në vit, në mënyrë të pandërprerë.
3. “Buletini i Shkencave Gjeologjike” është vazhdim i revistës shkencore gjeologjike “Përbledhje Studimesh”.
4. Si vit i fillimit të botimit të tij njihet viti 1964, kur është botuar për herë të parë “Përbledhje Studimesh”.
5. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në rolin e botuesit të Buletinit të Shkencave Gjeologjike, njeh Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, si bashkëautor në procesin e realizimit të periodikut.
6. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave e realizon bashkautorësinë e tij nëpërmjet pjesëmarrjes në Bordin Editorial të “Buletini i Shkencave Gjeologjike”, nxitjes për të botuar në këtë periodik të stafit të tij shkencor e mësimdhënës, studentëve dhe doktorantëve si dhe mbështetjes financiare nga burimet e tij apo nëpërmjet nxitjes së sponsorizimeve të ndryshme.

Neni 2

Bordi Editorial, krijimi, funksionimi dhe detyrat

1. Bordi Editorial është organi shkencor i cili drejton procesin e realizimit të periodikut shkencor “Buletini i Shkencave Gjeologjike”.
2. Bordi Editorial përbëhet nga Kryctari i Bordit Editorial, anëtarët e Bordit Editorial, dhe Sekretari i Bordit Editorial (gjithsej 7anëtarë).
3. Kryetari dhc Anëtarët e Bordit përfaqësojnë personalitetë në fushën e Gjeoshkencave, brenda dhe/ose jashtë vendit. Ata janë njohës të kualifikuar të problematikave që trajton periodiku.
4. Përbërja e Bordit Editorial krijohet sipas këtij rendi, tre anëtarë përzgjidhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, tre anëtarë përzgjidhen nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minicrave, dhe Sekretari i Bordit Editorial.
5. Sekretari i Bordit Editorial përfaqëson Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, si botues i “Buletini i Shkencave Gjeologjike” dhe përgjigjet për organizimin e imbarëvajtjen e punës së Bordit Editorial.
6. Kandidaturat e përzgjedhura nga insitucionet e sipërpërmendura i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, dhe certifikohen prej tij nëpërmjet Urdhërit përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
7. Shkarkimi i një antari dhe i gjithë Bordit Editorial bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar kur cënohet rëndë imazhi i Buletinit të Shkencave Gjeologjike nga veprimi ose mosveprimi i një anëtarë të Bordit apo i gjithë Bordit.

Neni 3

Mandati i Bordit Editorial, zgjedhja dhe rizgjedhja e anëtarëve të Bordit editorial

1. Mandati i Bordit Editorial është 3 (tre) vjeçar me të drejtë përsëritje një herë.
2. Mandati fillon prej mbledhjes së parë të tij. Bordi zhvillon mbledhjen e tij të fundit brenda muajit të fundit të mandatit, dhe në këtë mbledhje paraqet Vendimin për përfundimin e veprimtarisë dhe tërheqjes së tij, dhe i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me kërkesën për të certifikuar Bordin Pasardhës.
3. Anëtarët e Bordit Editorial kanë mandat që zgjat aq sa mandati i Bordit Editorial, prej mbledhjes së parë deri në mbledhjen e fundit. Ata mund të zgjidhen deri në dy mandate pa ndërprerje

Neni 4

Kryetari i Bordit (Kryeredaktori), Zgjedhja, detyrat dhe mancati i Kryetarit të Bordit Editorial

1. Kryetar i Bordit Editorial emërohet një nga anëtarët e Bordit propozuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.
2. Emërimi i Kryetarit të Bordit bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar pasi të ketë marrë mendim nga anëtarët e Bordit.
3. Kryetari i Bordit Editorial udhëheq veprimtarinë e Bordit Editorial prej momentit të mbledhjes së parë të këtij Bordi, deri në mbledhjen e parë të Bordit pasardhës.
4. Ai harton dhe paraqet për diskutim politikën editoriale të periodikut shkencor, dhe është garant i etikës, barazisë në trajtim, lirisë së shprehjes dhe mendimit, i të drejtave të autorit që rrejdhin nga ligjet shqiptare dhe konventat ndërkombëtare si dhe mbrojtjes nga diskriminimit i çdo lloji.
5. Detyra e tij quhet e përfunduar kur ai i dorëzon detyrën zyrtarisht tek Kryetari i Bordit Editorial që c' pason në detyrë, gjatë mbledhjes së parë të Bordit pasardhës. Në këtë mbledhje, Kryetari i Bordit të t'rhequr, bën një resume të veprimtarisë së Bordit Editorial që ka drejtuar përpara Bordit të ri, duke theksuar pikat kryesore të veprimtarisë dhe detyrat c' lëna të papërfunduara për tu vazhduar nga pasardhësit. Mbas kësaj ai i dorëzon zyrtarisht detyrën Kryetarit që e pason.
6. Kryetari i Bordit Editorial mund të rizgjidhet në këtë detyre, por jo më shumë se dy herë rrjesht.

Neni 5

Dorëheqja e Kryetarit të Bordit Editorial dhe mënyra e zëvendësimit të tij.

1. Kryetari i Bordit Editorial mund të lerë detyrën e tij edhe nëpërmjet dorëheqjes.
2. Dorëheqja nga posti i Kryetarit të Bordit Editorial, nuk nënkupton automatikisht dorëheqjen nga anëtarësia e tij në Bordin Editorial, prandaj në rast dorëheqjeje, ai qëndron përsëri si anëtar i Bordit Editorial,
3. Mbas dorëheqjes së Kryetarit të Bordit Editorial, një nga anëtarët e tjera të Bordit emërohet "Kryetar i përkohshëm i Bordit Editorial".
4. Mandati i "Kryetarit të Përkohshëm të Bordit Editorial", përfundon me mbarimin e mandatit të Bordit që ai kryeson, por mandati i tij është me të drejta të plota, prandaj ai nënshkruan nën titullin Kryetari i Bordit Editorial i "Buletini i Shkencave Gjeologjike".

5. Nëse Kryetari i Bordit bën dorëheqje të dyfishtë, pra edhe nga posti i anëtarit të Bordit Editorial, më parë bëhet zëvendësimi i tij nga një anëtar i ri i propozuar nga institucioni prej të cilit vjen Kryetari i Bordit, dhe pastaj bëhet emërimi i Kryetarit të Përkoħshem të Bordit Editorial.
6. Një Kryetar që dorëhiqet, nëse kjo ndodh në kohën kur ai po ushtron te mandatin e tij të dytë, ai nuk gëzon të drejtën e emëritimit në krye të Bordit pasardhës sepse mandati i tij do të konsiderohet i konsumuar, pavarësisht dorëheqjes.
7. Kryetari i Përkoħshem i Bordit, i emëruar në mes të mandatit, ka të drejtën e rizgjedhjes njësoj sikur të mos kishte qenë kryetar, dmth deri në dy mandate të njëpasnjëshme.

Neni 6

Shkarkimi i Kryetarit të 1 orcit Editorial dhe mënyra e zëvendësimit të tij

1. Kryetari Bordit Editorial mund të shkarkohet vetëm atëherë kur ai:
 - a. në mënyrë të vetëdijshme, me veprime apo mosveprime, ka favorizuar botiminii në faqet periodikut, të artikujve me karakter fyes e denigrues, apo me përbajtje diskriminuese ndaj fesë, racës, etnisë apo prirjeve seksuale të një personi apo një grupei personash;
 - b. kur ai me deklarimet e tij, shkel ligjin për mosdiskriminimin në Republikën e Shqipërisë;
 - c. kur nuk ka marrë parasysh ruajtjen e të drejtave të autorit të një dorëshkrimi të dorëzuar, apo të pjesëve të cituara nga vepra të tjera në një dorëshkrim të dorëzuar;
 - d. kur pengon botimin e një dorëshkrimi i cili bie ndesh me pikëpamjet e tij personale;
2. Shkarkimi bëhet mbasi:
 - a. dikush ngre akuzën se preket nga ndonjë prej veprave të pikave a, b, c, d të paragrafit 1 të këtij nenit, në këtë rast Bordi Editorial mblidhet të shqyrtojë çështjen, në një mbledhje që drejtohet prej Sekretarit të Bordit, në të cilën, Kryetari i Bordit merr pjesë vetëm për të paraqitur pretendimet e tij.
 - b. në fund të mbledhjes bëhet votim i fshehtë mbi argumentin e diskutuar, dhe në rast se akuza pranohet nga 4 prej 7 anëtarëve, i kalohet Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar mandati për vendimarrjen përfundimtare.
 - c. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, vendos për “paralajmërim” në mënyrë shkarkim” ose për “shkarkim” të Kryetarit, dhe ja përcjell vendiminii Bordit Editorial.
 - d. Vendimi “paralajmërim për shkarkim” mund të merret vetëm një herë, dhe në një rast të përsëritur Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, është i detyruar ta shkarkoje përfundimisht Kryetarin e Bordit Editorial.
5. Mbas Vendimit për shkarkim të Kryetarit të Bordit Editorial, fillon procedura për zgjedhjen e Kryetarit të Përkoħshem të Bordit Editorial, sipas paragrafeve 4, 5, 6, 7 të nenit 5 të këtij Statuti.

Neni 7

Sekretari i Bordit Editorial, detyrat dhe kohëzgjatja e mandatit.

1. Sëbashku me Kryetarin e Bordit Editorial është përfaqësues i politikave të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në fushën e botimeve shkencore. Emërohet dhe shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
2. Merr pjesë në mbledhjet e Bordit Editorial, me të drejtë vote, ku mbulan procesin e protokollimit të mbledhjes, dhe diskuton mbi çështjet teknike të botimit të periodikut, të cilat i mbulan

drejtpërdrejt dhe çështjet e tjera që diskutohen në mbledhjet e Bordit Editorial.

3. Merr në dorëzim dorëshkrimet nga autorët dhe i kontrollon për realizimin në to të "Kërkesave ndaj autorëve". Për këtë ai përgatit një raport shoqëruesh për secilin artikull dhe ja paraqit atë Kryetarit të Bordit Editorial.
4. Mbulon proçesin e publikimit on-line të periodikut.
5. Harton listat e pagesave për anëtarët e Bordit Editorial.
6. Harton listat e pagesave të ekspertëve të artikujve.

Neni 8

Redaktori përgjegjës dhe detyrat e tij.

1. Redaktori përgjegjës përgatit një raport shoqëruesh për secilin artikull dhe ia paraqit atë Sekretarin e Bordit Editorial.
2. Mban lidhje të përhershme me Sekretarin e Bordit Editorial dhe e informon për ecurinë e proçesit në vazhdimësi.
3. Ndjek proçesin e botimit dhe kontrollon zbatimi të shpërndarjes së periodikut.
4. Mban arkivin e proces-verbaleve dhe dorëzon një kopje origjinale çdo vit në Arkivin Qendror Teknik të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar si pjesë e materialit shkencor me afat ruajtje deri në 5 vjet.
5. Mban arkivin e dorëshkrimeve të dorëzuara dhe dokumentacionit lidhur me to dhe dorëzon një kopje origjinale të tyre çdo vit në Arkivin Qendror Teknik të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar si pjesë e materialit shkencor me afat ruajtje deri në 5 vjet.
6. Redaktori përgjegjës merr pjesë në çdo mbledhje por pa të drejtë vote.
7. Redaktori përgjegjës caktohet punonjësi që sipas organikës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar mbulon marrëdhëniet me jashtë dhe botimet.

Neni 9

Mbledhjet e Bordit Editorial, mënyrat e thirrjes dhe diskutimet në to.

1. Mbledhjet e Bordit thirren nga Kryetari i Bordit Editorial. Ai njofton anëtarët për mbledhjen e rradhës të paktën një javë më parë. Njëkohësisht, njofton Redaktorin përgjegjës që të dërgojë nëpërmjet e-mail-it të gjithë dokumentacionin (artikuj për tu diskutuar, përgjigje ekspertizash apo projekt-vendime), që do të diskutohen në mbledhjen që do të thirret.
2. Bordi diskuton dhe voton politikat editoriale të paraqitura nga Kryetari i Bordit, ndryshimet në rregullore që mund të propozohen, përcaktimin e ekspertit të artikujve, vendimin për të pranuar apo për ta refuzuar për botim një artikull, bazuar në kriteret teknike, apo vendimet e ekspertizës, çështje të së drejtës së autorit, përzgjedhjen e rradhitjes së artikujve në periodik në çastin kur ai çohet për botim, dhe korrektesën e ekspertëve në përputhjen e vlerësimit me kërkesat e formularit të ekspertizës.

Neni 10

Regullat e vendimmarrjes në Mbledhjet e Bordit Editorial

1. Vendimmarrja në Bordin Editorial bëhet me shumicë votash.
2. Minimumi i votës përvendimarrje është 50% e votave plus 1.
3. Anëtarët e Bordit kanë të drejtën e njërsës nga tre mënyrat e votimit: "Pro", "Kundër" apo "Abstain", ku dy të parat llogariten si një votë e plotë, ndërsa e treta me zero.
4. Në rastin kur votat "Pro" dhe "Kundër" janë të barabarta, vendos vota e Kryetarit.

5. Kryetari i Bordit Editorial mund të votojë vetëm “Pro” dhe “Kundër”.
6. Mbledhja e Bordit mbahet kur janë të pranishëm të paktën 5 votë nga Bordi Editorial.

Neni 11

Diskutimet On-line. Hapja e një diskutimi on-line, mënyra e votimit, vlefshmëria, dokumentimi dhe afatet

1. Përveç mbledhjeve fizike, për çështje të caktuara, Kryetari i Bordit drejtues shtron diskutime nëpërmjet e-mail-eve në të cilat përfshin të gjithë anëtarësinë e Bordit Editorial. Diskutimi zgjat jo më pak se një javë dhe përgjigjet e anëtarëve protokollohen nga Redaktori Përgjegjës.
2. Në fund të diskutimit Kryetari i Bordit mund të kërkojë marrjen e një votimi nëpërmjet e-mail-it. Votimi zgjat tre ditë, dhe vendimi quhet i marrë nëse deklarojnë mendimin e tyre të paktën 4 (katër) nga anëtarët e Bordit, dhe vota përcakton shumicën, 50% plus 1 të pjesmarrësve në votim. Rezultati i këtij votimi shkruhet në procesverbalin e mbledhjes së rradhës.
3. Propozimi për një votim të tillë mund të anullohet nëse 3 (tre) prej anëtarëve e refuzojnë këtë. Në këtë rast vendimmarrja mbi çështjen e diskutuar merret në mbledhjen e parë të Bordit Editorial, jo on-line.
4. Afati për kundërshtimin e vendimit për mbledhjen on-line është dy ditë nga dita e shpalljes së propozimit nga Kryetari i Bordit për një diskutim të tillë. Shpallja është e vlefshme kur dërgohet në e-mail ose me “sms” tek secili anëtar i Bordit Editorial dhe konfirmohet prej tyre.

Neni 12

Caktimi i ekspertëve për artikujt

1. Vlerësimi shkencor i artikujve bëhet nga ekspertët.
2. Për të vlerësuar artikujt e paraqitur nga pikëpamja e vlerave shkencore, Bordi Editorial cakton, nëpërinjet diskutimit dho votimit, ekspertin përkatës.
3. Eksperti duhet të jetë profesionist i fushës dhe njohës i mirë i problemit që trajton artikulli. Ai nuk mund të jetë pjesëtar i Bordit Editorial, bashkëautor i artikullit të paraqitur, apo bashkëautor i artikullshkruesit në një apo disa artikuj të mëparshëm, që trajtojnë një temë të përafërt apo janë pararendës të temës që trajton artikulli i dorëzuar.
4. Eksperti kontraktohet nëpërmjet një kontrate tip, të hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar të nënshkruar nga eksperti i kontraktuar, Kryetari i Bordit dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
5. Kur Bordi i shikon të arsyeshme për shkak të vështirësisë së artikullit apo kompleksitetit të temave që trajtohen në të, mund të caktohen dhe kontrakothen dy ekspertë.
6. Një ekspertizë e dytë mund ti bëhet një artikulli, kur Bordi e gjykon se eksperti i parë nuk ka arritur ti trajtojë të plota të gjitha kërkesat.
7. Eksperti e trajton artikullin brenda kohës së përcaktuar në kontratë dhe në bazë të pyetësorit të miratuar nga Bordi Editorial, i emërtuar “Formular i ekspertizës”, i cili është dokument standart dhe i dorëzohet ekspertit sëbashku me kontratën dhe artikullin.
8. Emri i ekspertit mbahet i fshehtë për autorin e artikullit, dhe emri i autorit të artikullit mbahet i fshehtë për ekspertin, për të eleminuar mundësinë e ndikimit në vlerësim.

Neni 13

Marrëdhëniet me autorët e artikullit, mënyra e dorëzimit dhe pranimi i artikujve, kthimi i përgjigjeve.

1. Çdo autor që kërkon të botojë në faqet e "Buletini i Shkencave Gjeologjike", duhet të respektojë disa kërkesa standarte, të cilat janë të nevojshme për të siguruar cilësinë shkencore dhe vizive të botimit, barazinë, të drejtën e shprehjes, etikën e shprehjes dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.
2. Autorësia duhet të jetë e limituar vetëm për ata që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm teknik në punën e paraqitur në dorëshkrim.
3. Renditja e autorëve duhet të dakortësohet nga të gjithë autorët dhe nuk mund të ndryshohet ndërkoq që dorëshkrimi është dorëzuar.
4. Asnjë individ që ka dhënë një kontribut të rëndësishëm teknik në punën e paraqitur në dorëshkrim, nuk duhet të përjashtohet nga autorësia.
5. Dorëzimi i artikullit shoqërohet me një deklaratë të autorëve ku dëshmojnë se c' dinë që janë bashkeautorë në këtë punim dhe se pranojnë si autor të parë, autorin të cilit i shkruhet emri i pari dhe që caktohet përgjegjës për korrespondencën me Bordin Editorial.
6. Ata duhet të deklarojne se kane parë versionin përfundimtar të materialit, dhe ka rënë dakort për paraqitjen e tij për botim. Asnjë emër fiktiv nuk duhet të jepet si autor ose bashkëautor.
7. Autorët e paraqesin artikullin e tyre tek Redaktori Përgjegjës i Bordit Editorial, në një kopje të printuar dhe një kopje elektronike. Kopja elektronike do të jetë e ndarë në materialin e parë në format **.pdf**, në materialin e dytë në format **.doc** ose **.docx** vetëm me tekstin pa figura, dhe në një dosje (folder) ku të jenë vendosur të gjitha materialet grafike, dhe tabelat në formën e madhësinë që do të paraqiten në artikull.
8. Në momentin e dorëzimit ata plotësojnë një formular në të cilin pranojne se mbajnë përgjegjësi përpëra ligjit për të drejtat e autorit, për ato që kanë paraqitur në këtë artikull.
9. Në momentin e paraqitjes Redaktori Përgjegjës që merr në dorëzim artikullin e kontrollon atë për përputhjen me kërkesat e formatimit.
10. Çdo shkelje e këtyre parametrave raportohet nga Redaktori Përgjegjës tek Sekretari i Bordit dhe ai propozon në mbledhjen e parë që artikulli ti kthitet autorit për ripunim për ta përputhur atë me kërkesat e formatimit.
11. Nëse artikulli i respekton kërkesat, ai kalon në Bordin Editorial për diskutim dhe për përcaktimin e ekspertit.
12. Nëse eksperti e vlerëson artikullin të përshtatshëm për botim ai diskutohet në Bordin editorial dhe votohet për botimin e tij.

Neni 14

Kërkesat ndaj autorëve

1. Ky nen ka për qëllim njohjen e autorëve që paraqesin artikuj për botim në "Buletini i Shkencave Gjeologjike", me kërkesat teknike që duhen zbatuar për paraqitjen e këtyre artikujve.
2. Dorëshkrimi i dorëzuar duhet të jetë origjinal dhe i pa publikuar më parë, dhe i padorëzuar për publikim në një vend tjeter. Dorëshkrimi dorëzohet në gjuhë korekte shqipe, dhe pas vendimit të Bordit Editorial për botim autori e përkthen atë në anglishtë korakte shkencore e zyrtare.

3. Materiali dorëzohet në formë elektronike dhe të printuar tek Redaktori Përgjegjës i Bordit Editorial.
4. Në formën elektronike përfshihen tre forma. Forma e parë përfshin një material në format PDF, ku të përbledhë artikullin e plotë me tekst, material grafik dhe tabelat me diçitura sipas renditjes që autori/autorët mendojnë ta botojnë. Në formën e dytë në MS Word, do të paraqitet pjesa tekst në format (DOC, apo DOCX), e cila përfshin tekstin dhe diçiturat e materialit grafik dhe tabelave, të cilat do të vihen në fund të materialit. Forma e tretë është një folder në të cilën të jetë vendosur i gjithë materiali grafik (foto, figura, grafike, skica, diagrama) në format JPEG, JPG, TIFF dhe tabelat ne formatin e MS Word. Këto materiale grafike dhe tabelat duhet të llogariten që të jenë shprehësc brenda formatit të një kolone (permasat 80x150 mm), ose dy kolonave (nje faqeje të plotë me përmasa 124x150mm).
5. Artikulli i plotë, duhet të përfshijë në një total prej 10 faqesh tekstin, materialin grafik dhe tabelat se bashku me diçiturat përkatëse si dhe listën e referencave.
6. Në faqet e Periodikut, ka vend për një rubrikë diskutimesh, apo artikujsh “Case Study” të cilat trajtojnë në formë të hollësishme një problem gjeologjik me rëndësi kombëtare në konceptin shkencor. Në këtë rast artikulli pranohet në gjuhën shqip, deri në maksimumi 15-16 faqe me një përbledhje në gjuhën angleze jo më pak se 3 faqe dhe jo më shumë se 5 faqe.
7. Përbledhja që e shoqëron, duhet patjetër të citojë të gjithë kapitujt e artikullit, duke cituar figurat dhe çdo koncept. Për shqyrtimin e tij redaksia cakton një grup anetarësh i cili i vjen në ndihmë autorëve, në mënyrë që ata të theksojnë sa më mirë konceptet e tyre **në artikull dhe në përbledhje**.

Neni 15

Standartet e dorëshkrimit:

1. Teksti i dorëshkrimi paraqitet në madhesinë e faqes A4 (përmasa 21x29,7cm), hapësira mes rrjeshtave “*Line spacing*” : *single*, çka nenkupton një sasi te perafert prej 800 fjalësh për faqe.
2. Permasat e shkrimit “*font size*”, *do te jene 12pt* (Times New Roman), dhe hapësira në anët e fletës “*margins*” *do te jete 3 cm* në anën e majtë (Left margin) dhe *2,5 cm* në të anët e tjera (right-top; djalatash-right; poshtë-bottom). Faqet duhet të janë renditur sipas numrit të tyre (page number), duke nisur nga njëshi.

Neni 16

Skema e ndërtimit të artikullit

1. Artikulli do të ndërtohet duke respektuar skemën e mëposhtme:
 - a) **Titulli (bold 12 pt)**: Sa më i shkurtër dhe përbledhës të jetë e mundur.
 - b) **Autorësia (italic 10 pt)**: Emër Mbiemër shoqëruar me indekse sipër mbiemrit (1), (2) etj., të cilat shoqërohen me referimin e plotë të emërtimit dhe adresës të institucionit nga vjen autori që i përkon indeksi. Indekset me adresat renditen menjëherë poshtë autorëve, secila në një rrjesht duke nisur nga adresa e autorit të parë, e cila shoqërohet dhe me një kontakt e-mail nëpërmjet të cilës Bordi Editorial mbani lidhjet me të.
 - c) **Abstrakti (italic 12 pt)**: në 250 fjalë (përafërsisht 15 rrjeshta) duhet të bëhet një përbledhje e shkurtër e qëllimit të punimit, përfundimeve dhe rezultateve kryesore. Abstrakti nuk duhet të përbajë referanca dhe shkurtim.

- d) Fjalët Kyçë (*italic 10 pt*): një sasi prej maksimumi 6 fjalësh kyç.
- e) Teksti kryesor (Times New Roman 12 pt).
- Ndërtohet i ndarë në seksione sipas rradhës: ***HYRJA, QËLLIMI, METODOLOGJIA E PËRDORUR, REZULTATET, DISKUTIMI I REZULTATEVE dhe PËRFUNDIME***. Titujt e seksioneve janë “bold”, “UPPERCASE” (krejt me shkronja kapitale) dhe mund të ndahen deri në dy nënseksione titujt e të cilëve dallohen në formatim në këtë mënyrë:
 - Seksion niveli i parë 1 · **TITULLI I SEKSIONIT** (bold & gërmëtë kapitale);
 - Nënseksioni i nivelit të parë 2: **Titulli i Nënseksionit 1** (bold, gërmëtë e parë e çdo fjale kapitale, të tjerat të vogla);
 - Nënseksioni i nivelit të dytë: *Titulli i Nënseksionit 2* (italik, gërmëtë e parë e çdo fjale kapitale, të tjerat të vogla).
 - i) Përdorimi i shkurtimeve: në artikull inund të përdoren shkurtime, kuptimi i të cilave duhet të jetë sqaruar në përdorimin e parë, p.sh., Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSII). Në citim në listën e referencave Buletini i Shkencave Gjeologjike shkurtohet në : Bul. Shk. Gjeol.
 - g) Njësitë: në Buletin njësitë e përdorura do ti përputhen Sistemit Ndërkombëtar të Njësive.
 - h) Diçiturat e figurave: duhen paraqitur nën çdo figurë në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, bashkë me referimet përkatëse.
 - i) Referencat: duhen paraqitur në tekst dhe në listën e referencave. Në teksten referenca paraqitet (Mbiemri E. viti) ku E. nënkuption initialin e emrit: Për referencë me dy autorë (Mbiemri 1 E1. Mbiemri 2 E2. Viti) për referencë me më shume se dy autorë (Mbiemri 1 E1., etj. al. viti).
 - Referencat në listën e referencave renditen sipas rendit alfabetik, ku i pari në rradhe është artikulli më i vjetër nga pikëpamja kronologjike. Nëse një autor apo një grup i njëjtë autorësh kanë botuar në të njëjtin vit dy apo më shumë artikuj që referohen në artikull, atëherë ata dallohen nga indekset A, B...etj (alfabeti latin dhe jo ai shqiptar) të cilat vendosen përparrë vitit dhe citohen në tekst. P.sh. (Mbiemri E. 1999A), (Mbiemri E. 1999B), e po kështu me rastet për dy apo më shumë se dy autorë.

Ngjesëtë në një paragraf citohen më shumë se një referencë ato fiten të gjitha në një kllapë rrumbullake dhe ndahen me pikëpresje (,). Psh (Mbiemri E. Viti; Mbiemri 1 E1., Mbiemri 2 E2. Viti).

Në listën e referencave duhet dalluar njëc referencë i përkct një libri të plotë, një kapitulli të vecante nga një liber, një Tezë ose mikrotezë PhD, një raporti apo një artikulli në një periodik shkencor.

 - Në referencë duhet paraqitur saktë titulli, viti, vendi i botimit dhe viti i botimit, kodet ISSN për revistat shkencore dhe ISBN për librat, si dhe sasia apo totali i faqeve të materialit të referuar.

Rradhitja e të dhënave të një referencë në listën e referencave është:

 - Emri “1” Mbiemri “1”, Emri “2” Mbiemri “2”,,, Emri “n” Mbiemri “n”. (viti i botimit). Titulli. *Lloji i materialit të cituar. Titulli i botimit nëse është revistë. Te dhënat e botimit. Vendi i botimit, numri i faqeve, kodi ISSN apo ISBN.*

Neni 17

Formulari i ekspertizës të artikullit të paraqitur në “Buletini i Shkencave Gjeologjike”

Formulari i ekspertizës, i dorëzohet ekpertit të caktuar nga Bordi Editorial, mbasi ai ka nëshkruar kontratën me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, çka tregon se ai e ka pranuar detyrën për ekspertizën e artikullit.

Nëpërmjet këtij formulari kërkohet prej ekpertit të vlerësojë me pikë artikullin, në drejtim të cilësisë teknike të të dhënavë të paraqitura në artikull, në drejtim të ndikimit e kuptueshmërisë dhe cilësinë e prezantimit grafik e gjuhësor të këtij artikulli në zhillimin e mendimit në fushën e trajtar.

Modeli dhe mënyra konkrete e vlerësimit sipas këtij formulari trajtohet në Linjat udhëheqëse për Etikën dhe estetikën e publikimeve në periodikun shkencor “Buletini i Shkencave Gjeologjike”.

Sistemi i pikëve për vlerësim do të jetë si më poshtë:

a. Cilësia teknike

Nota	Vlerësimi	Kriteret
3	I shkëlqyer	<p>Artikull i shkëlqyer, prezanton koncepte, aplikime ose metodologji inovative, ose këndvështrim të ri.</p> <p>Shpjegime të shkëlqyera të një pune të përfunduar, me konkluzoine përfundimtare, mbështetur tërësisht në teori, të dhëna ose rezultate të aplikueshme.</p> <p>Rezultatet publikohen për herë të parë.</p>
2	I cilësisë së lartë	<p>Artikull i një cilësie të lartë paraqet ide, teknika, rezultate ose interpretime të reja. Argumente të gjetura mirë që çojnë në konkluzione të reja, me përfundime të hartuara qartë dhe të shtjelluara.</p> <p>I vlefshëm për botim në revistë.</p>
1	I cilësisë së mirë	<p>Artikull i një cilësie të mirë, që përshkruan disa ide, teknika, rezultate ose interpretime të reja ku konkluzonet jane të qarta, megjithëse disa aspekte të punës mund të janë akoma në process.</p> <p>I tillë konsiderohet dhe një artikull që përshkruan idetë, teknikat, rezultatet ose interpretimet ekzistuese në një vështrim të ri si një vlerësim ose studim informativ.</p> <p>I vlefshëm për tu patur në konsideratë për botim në revistë.</p>
0	I dobët	<p>Artikull që nuk ka përbajtje të re dhe i parëndësishëm, është jo informativ ose jokorrekt. Artikulli përmban një ose më shumë difekte teknike serioze, të tillë që rezultatet janë jokorrekte ose konkluzionet nuk janë argumentuar. Jo i vlefshëm për botim në revistë.</p>

b. Ndkimi dhe kuptueshmëria e artikullit

Nota	Vlerësimi	Kriteret
2	I rëndësishëm	Artikulli përfaqëson një zhvillim që do të ketë një ndikim të madh në njojuritë shkencore ose metodologji.
1	Ndikues	Ka mundësi të ushtrojë ndikim në njojuritë shkencore ose metodologji.
0	Pa rëndësi	Ndikimi do qe i kufizuar ose i papërfillshëm në njojuritë shkencore ose metodologji.

c. Mënyra dhe gjuha e prezantimit

Nota	Vlerësimi	Kriteret
2	I shkëlqyer	Tekst i artikullit lehtësishët i kuptueshëm, figura të renditura mirë, ndërtuar mirë dhe shkallë të titulluara qartë.
1	Mirë	Tekst i qartë por me përsëritje. Figurat të mira por ndoshta shumë të ngjeshura ose shkalla e vështirë të lexohet.
0	I varfër	I vështirë për tu kuptuar prej gjuhës së paqartë ose figurave të varfra.

Vlerësimi total $a*b*c$.

- Të paktën një nga vlerësimet e barabartë me zero artikulli rishikohet aty ku çalon.
- Me 2 vlerësime të barabarta me zero artikulli nuk kalon.
- Me të treja vlerësimet të barabarta me zero artikulli nuk konsiderohet.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Statuti i Bordit Editorial hyn në fuqi 10 ditë pasi diskutohet në mbledhjen e pare të Bordit të krijuar, duke reflektuar ndryshimet e propozuara që kanë marrë miratimin e të paktën 4 anëtarëve të Bordit Editorial.

Miratohet



Tiranë 07.07.2020